
QASJA NDAJ NGJARJES NGA SHKRIMI GAZETARESK DHE AI LETRAR NË REGJIMIN TOTALITAR

*(Rasti i mbledhjes së 81 Partive Komuniste në Moskë. Analizë e romanit
“Dimri i madh” të Ismail Kadaresë dhe pasqyrimi i ngjarjes nga gazeta
“Zëri i Popullit”).*

Dr. ARTA SAKJA

Institucioni i Presidentit të Republikës

artasakja@hotmail.com

Abstract

This article proposes to study the different approaches that journalists and writers in totalitarian Albania have taken toward reporting and interpreting significant events under a regime that imposed strict controls on expression. The issue of the press-literature relationship will be examined through the lens of boundaries between the two distinct forms of discourse in their description of the same event.

It analyzes the unique and often conflicting methods by which each medium communicated the same event to the Albanian public. The study places particular focus on the dynamic interplay between reporting and creative interpretation in context where the state's control over narrative was near absolute.

Instances where a single event captivates both the press and the literary world in Albania are uncommon, given the rigid environment in which both journalists and writers operated. For a writer to be drawn to such an event, the occurrence must resonate with significant social or political relevance—something that transcends mere newsworthiness to engage with deeper national or ideological sentiments. This article specifically investigates this phenomenon through a focused analysis of Ismail Kadare's novel, “The Winter of Great Solitude”, as a literary response to a historical event.

In an illuminating 2001 interview with Illyria newspaper, Kadare provided rare insights into the core scenes of his novel, notably a pivotal chapter that recounts the infamous assembly of 81 communist party leaders in Moscow. In Kadare's depiction, these leaders form a “terrifying clan,” each harboring “poison and a dagger to strike one another,” revealing his critical perspective on the global communist bloc's internal power dynamics and Albania's

fraught place within it. Through literary technique, Kadare crafted a representation that transcends the event's surface narrative to reveal the lurking tensions and betrayals within this formidable alliance.

For the journalistic perspective, this article closely examines a selection of articles from "Zëri i Popullit"—the official Albanian newspaper of Socialist Party—published between November 1 and December 31, 1960. These articles provided daily updates and ideological framing of the event, marking a critical juncture in Albanian-Soviet relations. By analyzing the structure, language, and ideological undertones of this journalistic portrayal, the study highlights how the Albanian media orchestrated public opinion to reinforce the state's political objectives. It contrasts this with Kadare's narrative, which, while grounded in the same historical event, uses metaphor, symbolic imagery, and nuanced language to subtly convey dissent and reveal truths that official discourse obscured.

The contrasting approaches reveal the inherent differences in journalistic and literary "registers" as vehicles for depicting reality under authoritarianism. The journalist's role in a dictatorship is inherently limited by the constraints of the state's ideological expectations: information is filtered, structured, and delivered within the boundaries of Leninist press theory, adhering closely to the ideals of socialist realism that permeated all forms of public communication. Conversely, the writer—though equally constrained by censorship—possesses a unique capacity to use artistic expression as a means of evasion and subtle resistance. Through symbolic language and allegory, the writer can infuse deeper, sometimes subversive meanings that evade overt detection.

This study further explores the layered ways in which journalists and writers engaged with their audiences. Under a regime that suppressed dissent and limited the scope of public discourse, Albanians were often exposed to "official" versions of events. However, informal channels—gossip, personal letters, and clandestine discussions—allowed alternative perspectives to circulate. This creates a complex relationship between state-controlled media and literary texts: journalists may work within narrow confines to inform or reinforce ideological messages, while writers leverage the subconscious or veiled truths, allowing for a multiplicity of interpretations.

The journalist is tasked with situating the event within a defined temporal and spatial context, often clearly identifying state-approved "heroes" and "villains" and emphasizing consequences that align with the regime's objectives. By contrast, the writer approaches the event as creative material, employing a range of literary techniques—irony, symbolism, and layered narrative structures—that offer alternative interpretations.

Despite the strictures of dictatorship, the writer often manages to evade state control through what can be termed "artistic subversion." By embedding nuanced dissenting messages in his work, the writer is able to resist the totalizing narrative imposed on journalists and engage readers in a deeper exploration of reality.

This article sheds light on how literature, even when written under intense censorship, can serve as a subtle form of resistance, offering the reader insights and emotional truths that journalism—bound by the state's ideological strictures—cannot openly express.

Keywords: media, totalitarian propaganda, narrative structures, Leninist theory of the press.

Qasja ndaj ngjarjes nga shkrimi gazetaresk dhe ai letrar në regjimin totalitar

Hyrje

Ndodh që një ngjarje të ngjall frikë, panik apo shpresë. Që të shquajmë emocionet nga ngjarje të tilla, ngjarja ka nevojë t'i nënshtrohet interpretimeve të ndryshme, të zbardhet nga këndvështrime të ndryshme.

Kjo ngjarje mund të hyjë në sferën e shkrimit gazetaresk apo letrar, pasi këto shkrime mund të çmontojnë mekanizmat për ta bërë më të kuptueshme për opinionin publik.

Mënyra se si raportohet ngjarja lidhet me natyrën e shkrimit. Në sistemet demokratike, zbërthimi varet nga gazetari apo shkrimtari në mënyrë të drejtpërdrejtë. Në sistemet totalitare, gazetari dhe shkrimtari, përveç objektivave të tyre në raportimin e ngjarjes, kanë edhe disa filtra kontrollues.

Leximi i kujdesshëm i tekstit, qoftë ky gazetaresk, (artikull, koment, reportazh, interviste, deklaratë), apo tekst letrar, (një vepër letrare), do të na çonte drejt një analize të qasjes ndaj ngjarjes, vendosjen tekstuale të saj, procedurat narrative mbi të cilat artikulohej këto dy tekste.

Shkrimtari dhe gazetari u përkasin dy regjistrave të ndryshëm për nga forma se si ato e paraqesin realitetin e një ngjarjeje nëpërmjet aktit të të shkruarit. Në kontekstin e diktaturës, përtej formës që i japin informacionit, mjeteve që përdorin për t'iu afruar lexuesit dhe për të përfutur vëmendjen e tij, ata ndryshojnë në pozicionin që mbajnë ndaj ngjarjes, edhe pse ngjarja u shërben atyre si lëndë krijuese.

Pyetjet që bëhen në këtë artikull janë:

Si i përcjellin ata mesazhet e duhura të lexuesit që ka arritur të mësojë diçka në rrugët informale të komunikimit, në kushtet e një Shqipërie të izoluar, në një regjim totalitar që mbante nën kontroll të rreptë mjetet e informimit masiv?

Sa arrin gazetari të tejkalojë censurën dhe propagandën?

Arrin shkrimtari të tejçojë mesazhet që i çliron subkoshienca e tij apo vesh artistikisht të vërtetën që duan ta fshehin?

Ngjarja që ky artikull merr në konsideratë është Mbledhja e 81 Partive Komuniste e Punëtorë të Botës, e cila u mbajt në Moskë në datat 10 nëntor - 1 dhjetor 1960, ku mori pjesë një delegacion shqiptar i kryesuar nga sekretari i parë i KQPPSH-së, Enver Hoxha.

Në këtë mbledhje, Hoxha mbajti një fjalim më 16 nëntor, në të cilin iu kundërvu fjalimit të Hrushovit. Liderë të tjerë iu kundërvunë Hoxhës në mbrojtje të Partisë Komuniste të BRSS-së. Kjo mbledhje shënoi edhe nisjen e prishjes së marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe BRSS-së, si dhe afrimin e saj me Republikën Popullore të Kinës.

Sot nuk mund të mendohet që pa raportimin, komentimin në faqe të parë të një ngjarjeje si kjo, ngjarja të perceptohet si e tillë, por në Shqipërinë e vitit 1960 peizazhi ndryshonte.

Një ngjarje kaq e madhe për nga rëndësia duhet të mbushte faqet e para të medias vendase, por nuk ndodhi kështu. Fjalimi i Hoxhës dhe përplasja duhet të lexohet mes rreshtash për të kuptuar dramën.

Artikulli analizon si tekste gazetareske artikuj të gazetës “Zëri i Popullit” për periudhën nëntor 1960 - maj 1961, për të ekzaminuar qasjen që i është bërë ngjarjes së mbledhjes së 81 Partive në Moskë.

Është analizuar vendosja tekstuale e kësaj ngjarjeje, procedurat gjuhësore të përdorura në tekstet gazetareske dhe ato letrare, kuadratuat në kuadrin e medias në totalitarizëm.

*“Shtypi i shkruar dhe mediat zyrtare të vetmet që ekzistojnë përbëjnë elemente të sistemit politik autoritar. Mediat transmetojnë ato mesazhe informative që ofron vetë pushteti dhe pasi ia kalojnë publikut, vetë pushtetit prej të cilit varen i kthejnë jehonën që ky kërkon të dëgjojë”.*¹

Njëri nga gazetarët më me përvojë të kohës, Vangjush Zallëmi, i cituar nga Artan Fuga, shprehet mbi raportin që ka gazetari dhe redaktori në raportim në periudhën që po analizojmë: *“Parimet kryesore dhe teknikat e redaktimit nuk kanë ndonjë ndryshim të madh nga të gjitha proceset e shtypit. Duhet pasur kujdes nëse janë parë në mënyrë objektive faktet dhe ngjarjet për të cilat bëhet fjalë në shkrim. Së treti, përveç përmbajtjes së shëndoshë, a është punuar për një formë të përshtatshme? Si njeri politik, që ta kryejë mirë detyrën e tij, redaktori duhet të ketë njohuri të gjera e të thella në profilin e punës së tij, të njohë mirë vendimet dhe dokumentet e partisë, të jetë njeri me kulturë të gjerë, të përgjithshme profesionale”.*² Gazetari, pra, është një ilustrues i udhëzimit partiak.

Në Shqipërinë totalitare, *“fakti apo faktet nuk janë të njëjta me realitetin e jetës dhe në tërësinë e mesazheve që transmeton media.”*³ Sipas qasjes ideologjike që sundon në median e kohës, një fakt, sado i pranishëm të jetë në jetë, nuk e bën atë të vërtetë. Ai është fakt nëse ka vlerë shoqërore dhe i shërben përparimit shoqëror sipas Hamit Boriçit (1977). Çështja komplikohet pasi nuk ka kriteret e qarta mbi atë që i shërben përparimit shoqëror. Në kontekstin shqiptar të diktaturës *“faktet mediatike janë ato që përputhen me ideologjinë, politikën dhe propagandën në fuqi.”*⁴

Mekanizmi censurues është i frymëzuar nga ideologjia. Ai arrin të kontrollojë tërësisht dhe gjithçka nëpërmjet sistemit që pushteti ka ndërtuar për të patur në varësi të plotë median.

Në parathënien e romanit “Dimri i vetmisë së madhe”, Eric Faye, shkrimtar dhe kritik francez shprehet se Ismail Kadare e përdori ngjarjen: *“Për të ruajtur lirinë e*

¹ Artan Fuga, “Monolog. Mediat dhe propaganda totalitare”, Botimet Duda, 2010, fq.78.

² Artan Fuga, “Monolog. Mediat dhe propaganda totalitare”, Botimet Duda, 2010, f.88-89.

³ Po aty, fq.150.

⁴ Po aty, fq.151.

Qasja ndaj ngjarjes nga shkrimi gazetaresk dhe ai letrar në regjimin totalitar

tij të brendshme, në atë Shqipëri tepër dogmatike të fundit të viteve gjashtëdhjetë”⁵si edhe “e quan të nevojshme të shkruajë mbi ngjarjet që sapo kishin ndodhur, në mënyrë që t’i kishte duart e lira më pas, për t’iu rikthyer së shkuarës dhe legjendave, për të cilat kritikohej, ngaqë e kishte lënë pas dore Shqipërinë e re.”⁶

I pyetur mbi raportin e romanit me ngjarjen, nga gazeta “Dielli”, (6 janar 2004)⁷ vetë Ismail Kadare shprehet: “*“Dimri i vetmisë së madhe” ndryshe nga shumica e letërsisë komuniste, që i bënte jehonë ndarjes me Perëndimin, ky roman shtjellon një këndvështrim të kundërt: ndarjen me Lindjen. I shkruar e i botuar 30 vjet më parë, romani përshkruan iluzionin që lindi atëherë në Shqipëri; shpresën se Shqipëria, donte apo nuk donte, duke u shkëputur nga blloku komunist, do të bashkohej me Evropën. Në roman personazhet flasin haptas për këtë shpresë. Në këtë roman jepet një tablo globale e komunizmit, jashtëzakonisht e zymtë. Pjesa qendrore e romanit përshkruan mbledhjen e krerëve të 81 Partive Komuniste në Moskë. Pjesëmarrësit në këtë konferencë janë përshkruar si një klan i frikshëm, çdonjëri prej të cilëve mban të fshehur helmin dhe thikën për t’ia ngulur njëri-tjetrit.”*

Metodologjia

Për realizimin e këtij punimi është përdorur metoda e krahasimit. Në të krahasohet pasqyrimi i ngjarjes në roman dhe në gazetën *Zëri i Popullit* për të identifikuar dallimet dhe ngjashmëritë në mënyrën e trajtimit të ngjarjes. Gjithashtu, bëhet krahasimi i teknikave gazetareske dhe letrare: analizohen pasazhe nga teknikat e përdorura nga Kadare për të paraqitur realitetin dhe mënyrën se si gazeta përdor gjuhën për të mbajtur një kontroll të narrativës. Gjithashtu, krahasohet edhe ndikimi i medimeve: Si ndikojnë ato në perceptimin e ngjarjes nga publiku i kohës, dhe si ndikojnë në formimin e kujtesës historike. Po ashtu, punimi përfshin analizë letrare për të interpretuar tekstet e Kadaresë, duke u fokusuar në mënyrën se si ai krijon një univers simbolik për të komentuar shoqërinë dhe regjimin. Si dhe analizë gjuhësore dhe strukturore e gazetës “*Zëri i Popullit*” për të nxjerrë në pah mekanizmat e censurës dhe manipulimit të informacionit. Kjo mund të përfshijë analizën e përdorimit të figurave të gjuhës, toneve dhe stileve të veçanta që shërbejnë për të mbajtur kontrollin mbi narrativën.

Trajtesa teorike

Në regjimet totalitare, si ai komunist në Shqipëri, ka një kontroll të ngushtë

⁵ Ismail Kadare, “Dimri i Vetmisë së madhe”, Botimet Onufri, fq.ix, 2012.

⁶ Po aty.

⁷ Gazeta “Dielli”, 6 janar 2004.

mbi jetën politike, shoqërore dhe kulturore. Sipas Hannah Arendt-it, në “The Origins of Totalitarianism”⁸, këto regjime krijojnë një narrativë të kontrolluar që i imponojnë shoqërisë përmes propagandës dhe manipulimit të informacionit. Ky mekanizëm mund të shpjegojë se si ngjarje si mbledhja e 81 partive komuniste në Moskë pasqyrohen në mënyrë të kontrolluar, si në letërsi, ashtu edhe në media, për të mbajtur stabilitetin e regjimit. Sipas Edward Bernays-it në “Propaganda” (1928)⁹, propaganda është një mjet për të manipuluar mendimet dhe veprimet e masave.

Gazeta “Zëri i Popullit” shërbente si instrument për të formuar një narrativë që mbështeste regjimin dhe pasqyronte ngjarjet në përputhje me ideologjinë komuniste. Noam Chomsky, në “Manufacturing Consent” (1988)¹⁰, thekson se mediat janë të instrumentalizuara për të krijuar një konsensus të kontrolluar, ku informacioni është selektiv dhe i manipuluar për të mbajtur pushtetin.

Në letërsi, George Orwell në veprën “1984” përdor alegorinë dhe simbolizmin për të ilustruar një shoqëri totalitare ku çdo informacion është i manipuluar. Mikhail Bakhtin, në “The Dialogic Imagination” (1975), argumenton se letërsia ka një mundësi të rëndësishme për të sfiduar ideologjitë dominante, duke përdorur forma letrare të tilla si dialogu dhe përfaqësimi i konflikteve të brendshme. Kadare, në “Dimri i madh”, përdor alegorinë për të kritikuar ndikimin e Bashkimit Sovjetik dhe situatën politike të Shqipërisë, duke krijuar një realitet të deformuar përmes ngjarjeve të dukshme, por të kontrolluara.

Ndërsa John B. Thompson, në “The Media and Modernity” (1995), thekson se media ka një rol të rëndësishëm në forcimin e strukturave të pushtetit dhe mbështetje të narrativave të shtetit. Gazeta “Zëri i Popullit” pasqyronte ngjarjet në përputhje me qëllimet e regjimit për të ruajtur pushtetin dhe për të krijuar një realitet të përshtatshëm ideologjik. Sipas Tomas D. Kemple-it, në regjimet totalitare, shteti ka kontroll mbi informacionin dhe mediat për të pasqyruar ngjarje në mënyrë që i shërbejnë stabilitetit të pushtetit. Në kontekstin e censurës dhe autocensurës, Michel Foucault, në “Discipline and Punish” (1975) analizon mënyrën se si individët dhe media internalizojnë kontrollin dhe vetëpërmbahen për të shmangur ndëshkimin. Ky koncept është i rëndësishëm për të kuptuar kufizimet që gazetarët dhe shkrimtarët shqiptarë përjetuan gjatë periudhës komuniste, duke pasqyruar ngjarje të deformuara për të ruajtur sigurinë personale.

Boris Groys, në “The Total Art of Stalinism” (1992)¹¹, analizon si realizmi socialist u përdor për të formuar një botë të kontrolluar nga ideologjia shtetërore.

⁸ Arendt, H. (1951). *The Origins of Totalitarianism*. Harcourt Brace.

⁹ Bernays, E. (1928). *Propaganda*. Horace Liveright.

¹⁰ Chomsky, N., & Herman, E. S. (1988). *Manufacturing Consent: The Political Economy of the Mass Media*. Pantheon Books.

¹¹ Groys, B. (1992). *The Total Art of Stalinism: Avant-Garde, Aesthetic Dictatorship, and Beyond*. Princeton University Press.

Kadare përdor një stil alegorik për të reflektuar ndikimin e sistemit komunist dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, duke përdorur simbole dhe alegori për të kritikuar regjimin dhe për të pasqyruar realitetin e shtypjes dhe manipulimit. Ky aparat teorik ofron një kuadër për të analizuar se si ngjarjet politike dhe shoqërore, si Mbledhja e 81 Partive Komuniste, janë pasqyruar në dy medime të ndryshme: gazetaria dhe letërsia. Përmes këtyre teorive, mund të kuptojmë sesi regjimi komunist përdorte propagandën, censurën dhe manipulimin e informacionit për të kontrolluar narrativën dhe për të ruajtur pushtetin, si dhe sesi gazetarët dhe shkrimtarët përdornin teknika letrare dhe gazetareske për të sfiduar kufizimet e lirisë së shprehjes.

Karakteristikat dhe funksionet e shkrimit gazetaresk dhe atij letrar në regjimet totalitare

Shkrimi gazetaresk

Shqipëria përgjatë periudhës totalitare ndoqi teorinë leniniste të shtypit. Roli i medias, sipas kësaj teorie është i drejtpërdrejtë. Ato janë mjete të propagandës, bindjes dhe edukimit. Funksioni i tyre si burim informacioni dhe argëtimi vjen në radhë të dytë. Kjo filozofi e ka zanafillën që nga Lenini, i cili deklaroi se shtypi komunist ekzistonte për të çuar më tej çështjet e revolucionit dhe si ai ishte arma më e fortë e partisë, moto kjo që u avancua nga Stalini, i cili e konsideronte shtypin si instrumentin më të fortë me anë të së cilit, dite pas dite, orë pas ore partia u fliste masave me gjuhën e saj.

Ndërkohë Enver Hoxha kishte vendosur më egërsisht sipas Artan Fugës, *“Struktura ligjore e shtypit dhe medias në Shqipëri lëkundet midis pohimit formal në letër të lirisë së shprehjes, shtypit dhe eliminimit real të tyre”*. Që nga viti 1952, në një mbledhje të byrosë politike, E. Hoxha ua bën të qartë gazetarëve një herë e përgjithmonë: *“Shtypi nuk mund të jetë i pavarur nga partia, se kjo shpie në shkëputjen e tij dhe në mospasqyrimin si duhet të vijës së drejtë të saj. Direktivat që jep Komiteti Qendror, redaksia e gazetës “Zëri i Popullit” duhet t’i marrë si urdhra.”*¹²

Sipas Fugës, mediat kishin një varësi me natyrë të dyfishtë brenda dhe jashtë mediatike. Elementë të kësaj strukturë varësie janë: Komiteti Qendror i jep porosi Shefit të Sektorit të Shtypit pranë Komiteti Qendror, ai i jep Kryeredaktorit të çdo gazete, ky ia kalon Redaktorit, ai Gazetarit dhe Korrespondentit vullnetar, që është punonjës ose “kuadro i terrenit”.¹³

Një karakteristikë tjetër e shtypit në këtë periudhë, sipas profesor Fugës, është

¹² Artan Fuga, “Monolog. Mediat dhe propaganda totalitare”, Botimet Dudaj, 2010, f.104.

¹³ *Po aty*.

se informacioni mediatik i nënshtrohet një prirjeje krejt specifike, maksimizohet sasia e informacionit në njësinë e kohës për banor, ndërkohë që minimizohet gjithmonë e më tepër cilësia, larmia dhe tipologjia ideore e këtij informacioni që kalon nëpërmjet kanaleve zyrtare të komunikimit.

Është kjo hierarki që vendos se cila ngjarje përbën lajm dhe se si ngjarja duhet të transmetohet në një lajm. Mbledhja e 81 Partive në Moskë është parë si ngjarje që përmbush shumicën e potencialeve të kërkuara e “të pranuar nga shumica e gazetarëve”. Sipas Joseph Dominick-ut, që një ngjarje të raportohet në media për nga aktualiteti, spikatja, (prania e Enver Hoxhës në delegacion është një burim i padiskutueshëm lajmi), ndikimi (ngjarja ndikon në fatin e popujve të shumë vendeve socialiste), interesi njerëzor (drama e lajmit duhet të mbytet).

Ngjarja duhet, gjithashtu, të raportohet, duke iu përgjigjur pyetjeve kanonike që ngjall te lexuesit ngjarjen e raportuar me fjalë, kush - aktorët; çfarë - faktet; ku – vendin; kur - momentin; si - zhvillimin e ngjarjeve, dhe përse – motivet që shkaktojnë ngjarjet. Me anë të këtij aktiviteti deklarues dhe diskursiv, ngjarja bruto (fakti ekstratekstual shndërrohet në “ngjarje të ndërtuar”¹⁴, siç e quan Patrick Charadau dhe ndërtimi verbal i kuptimit lejon interpretimin e saj nga ana e lexuesit.

Shkrimet gazetareske janë kryesisht të klasifikuara në dy lloje: *artikujt informativë*, ku hyjnë: lajmi i thjeshtë, deklarata e shtypit, reportazhi, etj, të cilët paraqesin kryesisht faktet, si edhe *artikujt komentues*, ku nëpërmjet opinioneve, marrjes së pozicioneve dhe gjyimeve të faktit që raporton, gazetari i jep një dritëhije të caktuar ngjarjes, synon të përpunojë opinionin mbi ngjarjen, (si kryeartikulli, kronika, opinionin, komentin).

Nga një analizë të gazetës “Zëri i Popullit”, nga 1 nëntori i 1960 - 31 dhjetor 1960, për këtë ngjarje rezultojnë 12 artikuj mbi Mbledhjen e 81 Partive Komuniste e Punëtores në Moskë. Është zgjedhur kjo periudhë që përkon me udhëtimin, kohën e mbajtjes së mbledhjes në Moskë, kthimin në atdhe të pjesës së parë të delegacionit dhe pjesës së dytë të tij. (Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu i lanë përgjysmë zhvillimet e Mbledhjes së 81 Partive në Moskë, siç na sqarojnë dokumentet historike të CIA-s të zbuluara këto vitet e fundit).

Artikujt e listuar si më poshtë:

1. *“U nis për në Moskë delegacioni i PPSH-së, që do të marrë pjesë në festimin e 430-vjetorit të Revolucionit të madh Socialist të Tetorit”*.

(Njoftim telegrafik mbi qëllimin e udhëtimit të delegacionit, përbërjen, përcjelljen nga shokët e Byrosë dhe të Presidiumit të Kuvendit të Republikës Popullore të Shqipërisë, si edhe nënvizohet prania e të ngarkuarit me punë të Bashkimit Sovjetik dhe ambasadorit të Hungarisë).

¹⁴ Patrick Charadau, "Les médias, un manipulateur manipulé", në *La manipulation à la française*, Paris, 2003.

Qasja ndaj ngjarjes nga shkrimi gazetaresk dhe ai letrar në regjimin totalitar

2. *“U larguan nga Moska shokët Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu”*, 27.11.1960.

(Njoftim telegrafik mbi përcjelljen që i bëhet delegacionit në stacionin hekurudhor “Kievskaja” nga personalitetet ruse, personeli i ambasadës sonë në Moskë, si edhe studentët shqiptarë me studime në Moskë.)

3. *“Shokët Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu kthehen në atdhe”*.

(Njoftim telegrafik, përbërja e pritësve, ku vihet re një ndryshim në radhën e përmendjes së ambasadorit hungarez me atë të të ngarkuarit me punë në BS i cili rreshtohet i fundit.)

4. *“Mbledhje solemne në Moskë”*, 2.11.1960.

(Njoftimi telegrafik i TASS lajmëron nisjen e punimeve, folësin hapës të punimeve, shokun Kozllov, dhe pikat kryesore të fjalës së tij.)

5. *“Komunikatë mbi mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtorë”*, 2.12.1960.

Komunikata rreshton delegacionet pjesëmarrëse, si edhe nënvizon se pjesëmarrësit e mbledhjes shkëmbyen eksperiencat dhe u njohën me pikëpamjet dhe pozitat e njëri-tjetrit, diskutuan problemet aktuale të zhvillimit të sotëm ndërkombëtar dhe të lëvizjes komuniste në interes të luftës së përbashkët”, duke mos harruar të theksojë se “diskutimi u bë në atmosferën e miqësisë”.

6. *“Deklarata e mbledhjes së përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtorë”*, 6.12.1960. Kryeartikull

(“Në kompaktësinë, në unitetin e partive komuniste dhe punëtorë të popujve të vendeve socialiste, në besnikërinë e tyre ndaj doktrinës marksiste-leniniste qëndron burimi kryesor i forcës dhe i pathyeshmërisë së çdo vendi socialist dhe të kampit socialist në tërësi”).

7. *“Dokument programatik për lëvizjen komuniste ndërkombëtare”*, 7.12.1960.

Kryeartikull

Nënvizohet fakti se “deklarata është një fitore e marksizëm-leninizmit revolucionar, ku partitë komuniste e punëtorë, dhe masat punonjëse, gjejnë përgjigje për problemet më jetike të kohës, dhe se “kjo deklaratë është një dokument programatik për lëvizjen komuniste ndërkombëtare, ku përcaktohen pozitat parimore dhe deklarata e partive komuniste e punëtorë të të gjitha vendimeve lidhur me çështjet

më të rëndësishme të luftës së tyre të mëtejshme për paqen, pavarësinë kombëtare, demokracinë dhe socializmin”.

8. *“Masat tona punonjëse përshëndesin dhe aprovojnë njëzëri deklaratën e Mbledhjes së përfaqësuesve të Partive Komuniste e Punëtore”*, 8.12.1960.

(Korrespondentët vullnetarë sjellin opinione të intelektualëve dhe punëtorëve nga gjitha Shqipëria, të cilat aprovojnë atë që gazeta e quan “dokumentin e rëndësishëm programatik”).

9. *“Shprehje e re e unitetit të partive marksiste-leniniste. Jehona ndërkombëtare e deklaratës së mbledhjes së përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtore”*. 9.12.1960.

10. *“Masat tona punonjëse vazhdojnë të ndjekin me interes deklaratën e Mbledhjes së 81 Partive Komuniste e Punëtore”*, 20.12.1960.

11. *“Komunikatë e plenumit të Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë”*. 21.12.1960.

(Komunikata shpreh aprovimin njëzëri mbi raportin e shokut Enver Hoxha, si edhe gjithë veprimtarinë e delegacionit, aprovon deklaratën dhe thirrjen e mbledhjes së Moskës. Rezoluta thekson se: “Mbledhja e 81 Partive Komuniste e Punëtore provoi edhe një herë se takimet midis përfaqësuesve të partive, bisedimi i çështjeve bashkërisht, duke përdorur metodën e konsultimeve janë të vlefshme dhe të domosdoshme për përpunimin e pikëpamjeve të njëjta dhe koordinimin e veprimeve për qëllimet e përbashkëta”).

12. *“Uniteti i kampit të fuqishëm socialist, garanci e mbrojtjes së socializmit e të paqes në botë”*, 23.12.1960.

(Koment mbi deklaratën dhe thirrjen e mbledhjes së përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtore, që shihen si “armë të rëndësishme për lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare, në luftën për paqe, pavarësi kombëtare, demokraci dhe socializëm.”)

Sikundër shihet nga kjo paraqitje analitike e synuar e artikujve të botuar shtypi i qëndron besnik porosisë së partisë për të fshehur ngjarjen nëpërmjet artikujsh të thjeshtë informativë.

Qasja ndaj ngjarjes nga shkrimi gazetaresk dhe ai letrar në regjimin totalitar

Shkrimi letrar

Shkrimi letrar, sipas Roland Barthes, “është sipërfaqja fenomenale e veprës letrare, është një endje e fjalëve të angazhuara në vepër dhe të ofruara në atë formë që të imponojë një kuptim të qëndrueshëm, mundësisht unikal”.¹⁵ Shkrimtari përdor një shumësi mjetesh gjuhësore për të prodhuar një tekst që i nënshtrohet disa rregullave estetike dhe formale, normave gramatikore dhe atyre të poetikës dhe retorikës. Si vepër arti, teksti letrar mund të konsiderohet si një artikull shtypi. Sipas Roland Barthes: “është një vepër e gjuhës dhe është e domosdoshme të analizohet funksionimi i gjuhës në raport me funksionimin e ideologjisë zotëruese”.¹⁶ Në ndërtimin e tij teksti letrar ka përmasa të ndryshme, nga ku ne flasim për lexim të shumëfishtë të tekstit, si edhe karakterin e tij polisemik.

Mbi këtë pikë, Roland Barthes e përcakton atë: “Teksti letrar nuk është prodhim i përcaktuar vetëm nga ndërgjegjja krijuese, shkrimtari godet me magjepsje kuptimin dhe qëllimshëm, duke e kthyer fjalën drejt një fati përtej kuptimit”.¹⁷ Kështu për Barthes “shkrimi letrar është një realitet i dyfishtë; nga njëra anë ai lind në mënyrë të pakundërshtueshme nga përballja e shkrimtarit me shoqërinë në të cilën ai bën pjesë; nga ana tjetër nga ky qëllim shoqëror ai e çon shkrimtarin më një lloj transferimi tragjik në burimet instrumentalizuese të krijimit. Në pamundësi për t'i dhënë një gjuhë të konsumuar, Historia i propozon shkrimtarit krijimin e një gjuhe të prodhuar në lirinë e tij”.¹⁸ Për të njëjtin autor “që një ngjarje të përshkruhet, duhet të shkruhet”.¹⁹ Çdonjëra prej formave të shkrimit ndihmon në ruajtjen e origjinalitetit historik.

Letërsia shqiptare nën realizmin socialist

Letërsia shqipe përgjatë viteve të totalitarizmit u rreshtua nën rrymën e realizmit socialist.

Doktrina zyrtare e artit që sundoi në vendet socialiste pas gushtit 1934, kur u përcaktua si e tillë nga Kongresi i Shkrimtarëve Sovjetikë. Realizmi socialist kërkonte prej artistit “një përfaqësim të vërtetë historik, konkret të realitetit në zhvillimin e tij revolucionar. Përveç të tjerash, ai duhej të ndikonte ideologjikisht në edukimin e

¹⁵ Roland Barthes, “Le Degré zéro de l'écriture”, (1953).

¹⁶ Po aty.

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Po aty.

¹⁹ Barthes Roland. L'écriture de l'événement. In: *Communications*, 12, 1968. Mai 1968. La prise de la parole. Fq. 108-112.

punëtorëve me shpirtin e socializmit”.²⁰

Edhe pse ka një debat mbi përkatësinë apo jo të Kadaresë si shkrimtar i realizmit socialist, ky artikull e sheh atë për shkak të përkohësisë së veprave të tij letrare me rrymën letrare që sundoi vendin nën këtë rrymë.

Romani, vështrim socio-kritik

Në këtë pjesë të artikullit do të bëjmë një përpjekje modeste për të analizuar nën këndvështrimin socio-kritik. Socio-kritika, e lindur në fillim të viteve 1970, e punuar kryesisht nga revista “Littérature” dhe punimet e Claude Duchet-it. Ky projekt propozonte eksplorimin e një aspekti themelor të letërsisë, socialitetit apo përmasës shoqërore të teksteve letrare. Projekti synonte të tërhiqte, jo thjesht vëmendjen të konteksti, por të materiali i ligjërit. Sipas Duchet-it, “*megënëse e ka gjuhën në themel të tij dhe punën mbi gjuhën, teksti letrar është shoqëror. Ai nuk bëhet i tillë nisur vetëm nga tematika, por edhe nëpërmjet mënyrave të të thënit, modulimit të ligjërit shoqëror; orientimit të këndvështrimit të lexuesit mbi realen. Duke kërkuar në përmasën shoqërore në zemër të shkrimit, socio-kritika angazhohet në zbulimin e asaj që tekstet na ofrojnë mbi shoqërinë e shkuar dhe të sotmen, edhe kur ato, në kushtet e një ideologjie të caktuar, nuk i trajtojnë temat në mënyrë të drejtpërdrejtë*”²¹ Fillimisht, përpjekja jonë modeste synon ngritjen e një problematike të romanit. Romani është një analizë psikologjike e gjendjes së shoqërisë shqiptare gjatë periudhës totalitare.

Ndërsa përsa i përket ndërtimit tekstual të rrëfimit, autori i bindet strategjisë së tregimit tradicional, që kupton një situatë nisëse, një zhvillim të ngjarjeve dhe një zgjidhje finale. Ai ndjek një strukturë lineare me procese rrëfimtare, si tregimi i saktë i hapësirës, kohës, përshkrimi i personazheve që e bëjnë atë një tregim afër reales. Lënda krijuese është një ngjarje (Mbledhja e 81 Partive e shefave të komunizmit, fjalët, akuzat, kundërakuzat janë marrë nga dosjet e arkivit shqiptar).

Kemi në të vërtetë një histori të treguar pjesë-pjesë, e gërshetuar me pasqyrimin e përjetimeve mbi zhvillimin e ngjarjes nga heroi kryesor i veprës, me profesion gazetar, në rolin e përkthyesit të delegacionit shqiptar në Moskë, Besniku, i cili do të qetësojë, të qartësojë lexuesin dhe të administrojë pritjet e tij. Duke zgjedhur rrëfyesin, një gazetar lehtëson punën e tij për t’i qëndruar në një përqindje të konsiderueshme besnik raportimit të ngjarjes së vërtetë dhe duke mbajtur një ekuilibër midis trajtimit artistik dhe raportimit gazetaresk.

Ne mund të shikojmë ngjarjet me sytë e mendimet e tij. Ai ndërhyr për të përshkuar faktet dhe komentuar ato, apo për të prezantuar ngjarjet nëpërmjet

²⁰ Agron Tufa në : <https://palimpsest.al/realizmi-socialist/>.

²¹ Claude Duchet, “Une écriture de la socialite”, *Poétique*, nr. 16, 1973, fq. 446-454.

Qasja ndaj ngjarjes nga shkrimi gazetaresk dhe ai letrar në regjimin totalitar

dialogjeve midis personazheve të ndryshëm. Pamundësinë për të mbytur raportimin e ngjarjes, gjithashtu: - *“Një herë në një pritje te mongolët, ambasadori i tyre tregoi diçka për vdekjen e Xhenghis Kahnit, - tha Jordani. Ai vdiq diku në kufijtë e Kinës. Komandantët deshën të mbanin të fshehtë lajmin e vdekjes, së paku deri sa të çoheshin trupi për t’u varrosur në qendrën e Perandorisë. Një mijë roje udhëtonin ditë e natë bashkë me kufomën drejt Mongolisë. Për të mos u marrë vesh lajmi i vdekjes, rojet vrisnin në vend të gjithë njerëzit që u dilnin përpara apo shikonin rastësisht karvanin e përzishëm. Dhe jo vetëm njerëzit. Ata vrisnin çdo qenie të gjallë: zogjtë, bishat e egra, gjarpërinjtë. E megjithatë, e fshehta nuk u mbajti dot.”*²²

“Dimri i vetmisë së madhe” është një roman me pesë pjesë, 27 krerë, ku Mbledhja e 81 Partive gjendet nga kreu VI, deri në kreun e X të romanit. Situata pas saj, deri në prishjen me BRSS-në dhe tërheqjen e nëndetëseve nga baza e Vlorës përshkruhet nga kreu X, deri në faqen e fundit.

Rrëfimtari ka një funksion qendror mbi emocionin që provokon tek ai historia, duke u përsiatur mbi personazhet dhe veprimet. Ai tregon historinë, të tijën dhe të të tjerëve: *“salla ishte zhytur në një heshtje të rëndë. Mbi tryeza, çantat e zeza dukeshin si bisha të vogla. Një pjesë e madhe e dëgjuesve i kishin fytyrat e skuqura. Sytë e tyre ishin të turbullt nga zemërimi. Duart lëviznin me nervozizëm prapa çantave. Disa kishin vënë mjekrën në grusht. Hrushovi e mbante kokën lart. Herë pas here vështronte anash. Përballë tij, kinezët dëgjonin me fytyra të ngurosur. Që pas shpinës së tij dikush i vuri përpara një dosje. Hrushovi pa diçka në të, pastaj e ngriti prapë kokën në një mënyrë të panatyrshme. Bullgarët nuk ia ndanin sytë. Mjekra kronike e Ulbrithit ishte gjithë pezëm.”*

Hapësira dhe vendi i zhvillimit të ngjarjes.

Vendi ku zhvillohet ngjarja është Moska dhe Tirana, që shërbejnë për një rrëfim realist, me këmbë në tokë të ngjarjes.

Ndërkohë që shkrimtari Kadare gjen mundësinë për të ndërhyrë në trajtimin ideo-emocional po t’i referohemi Teorisë së Realizmit Socialist duke zhvendosur pjesën e analizës emocionale, përjetuese në hapësirën ajrore midis Tiranës dhe Moskës gjatë udhëtimit të tij.

Figura e Enver Hoxhës

Kadare ka përzgjedhur t’i mbajë personazhet kryesorë të Mbledhjes së 81 Partive si personazhe të romanit. Kështu, gjejmë personazhe në roman, Hrushovin dhe Hoxhën. Mbi përshkrimin e këtij të fundit ka komente të ndryshme që e shpallin

²² Ismail Kadare, “Dimri i vetmisë së madhe”, Shtëpia Botuese Onufri, 2012, fq.115.

Kadarenë ose një shërbëtor të regjimit, ose disident të tij. Këndvështrimi kritik mbi gjuhën e përdorur prej tij, zbërthimi i çelësave stilistikorë, si edhe korniza e kohës, (totalitarizëm), ai që bën diferencën. Në funksion të kësaj analize theksojmë se autori i qaset ngjarjes.

“Përjashta, në oborrin e vilës po ecte vetëm në dëborë Enver Hoxha. Palltoja e zezë e bënte dhe më të gjatë shtatin e tij. Borsalinën e madhe, gjithashtu të zezë, e kishte rrasur thellë në kokë, me një shkujdesje dramatike, si një hall të madh. Hapat e tij nuk ishin të shpejtë, as të ngadaltë. Nuk ishte shëtitje. Ishte një ecje gjithsesi e shkujdesur, një lëvizje këmbësh gati e çrregullt, e rëndë, e lëkundshme, ndoshta nga sipërfaqja jo e sheshtë e vilës”,²³

Tirana pas ngjarjes na shfaqet e dykuptimtë

Heshtja e Besnikut, ndërsa korridoret e redaksive dhe rrugët e Tiranës pa zë komentojnë dramën e Moskës dhe është një tregues i tërthortë që autori ka dashur të na japë mbi censurën. Ndërkohë thashethemet e nëndheshme dhe kodet e luleve dhe kurorave që shfaqen në varre dëshmorësh e të persekutuarish na japin dimensionin tronditës të frikës dhe shpresës.

Konkluzione

Në regjimet diktatoriale, dallimet midis shkrimit gazetaresk dhe atij letrar shpesh janë të theksuara për shkak të kufizimeve dhe kontrollit shtetëror mbi informacionin.

Qasja ndaj ngjarjes së studiuar në këtë artikull nuk i ka shpëtuar këtij përkufizimi.

Shkrimi gazetaresk është zakonisht i kontrolluar dhe i censuruar për të mbështetur propagandën e regjimit.

Shkrimi letrar ka mesazhe të koduara ose alegorike në tentative për t’i shpëtuar censurës.

Shkrimi gazetaresk është rreptësisht i kufizuar dhe censuruar, duke iu përmbajtur narrativës së regjimit dhe duke shmangur ngjarjen e vërtetë.

Shkrimi letrar megjithëse edhe ky është nën kontroll, nëpërmjet përdorimit të gjuhës së figurshme, simboleve dhe alegorive arrin ta shmange kontrollin e drejtpërdrejtë.

Stili i gjuhës së shkrimit gazetaresk është i thjeshtë, i krijuar për t’u kuptuar lehtësisht nga masa, formal dhe propagandistik.

Shkrimi letrar ka stil të pasur dhe përdor gjuhë figurative, me qëllim që të ndërtojë një kuptim më të thellë dhe shpesh metaforik të realitetit.

²³ Ismail Kadare, “Dimri i vetmisë së madhe”, Shtëpia Botuese Onufri, 2012, fq.168.

Qasja ndaj ngjarjes nga shkrimi gazetaresk dhe ai letrar në regjimin totalitar

Kontrolli dhe censura:

Gazetarët janë në kontroll të plotë dhe duhet të shmangin çdo fjalë që mund të çënojë imazhin e regjimit. Ata punojnë nën frikën e ndëshkimeve për çdo devijim që mund të kapin kontrolluesit e shkrimit.

Shkrimtari i cili gjithashtu është i rrezikuar, ka, megjithatë, më shumë hapësirë për të fshehur mesazhet e tyre në mënyrë indirekte përmes metaforave dhe alegorive.

Gazetari shkruan për të informuar, aq sa i lejohet nga kontrollorët e sistemit.

Shkrimtari mund të tejçojë mesazhet që i çliron subkoshienca e tij, duke e veshur artistikisht të vërtetën që duan ta fshehin.

Gazetari kornizon ngjarjen në hapësirë dhe kohë, identifikon aktorët dhe pasojat e ngjarjes, aq sa i lejohet.

Shkrimtari ushtrohet mbi objektin, përdor gjuhën duke respektuar disa teknika.

Shkrimi gazetaresk është shumë i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë; çdo simbolikë është e kufizuar dhe në përputhje me mesazhin që regjimi do të përcjellë mbi ngjarjen.

Shkrimi letrar e përdor simbolikën për të tejkaluar censurën dhe për të shprehur ide kundër regjimit, të cilat janë të vështira për t'u kuptuar drejtpërdrejt nga censuruesit.

Kështu, mund të themi se ndërsa shkrimi gazetaresk përqendrohet te përhapja e informacionit të kontrolluar nga regjimi, shkrimi letrar në regjimet diktatoriale, shpesh, bëhet një mjet i fuqishëm për të shprehur kundërshtimin dhe për të ruajtur lirinë e mendimit, ndonëse në mënyrë të fshehtë dhe artistike.

Korniza e diktaturës ngushton lirinë e shprehjes së gazetarit, shkrimtari i ikën kësaj kornize në sajë të mjeshtërisë artistike. Ai arrin të çlirojë mesazhe disidente në përshkrimin e kësaj ngjarjeje dhe na ofron të vërteta që shtypi nuk ka mundur t'i raportojë.

Bibliografia:

1. Arendt, H., (1951). The Origins of Totalitarianism. Harcourt Brace.
2. Artan Fuga, "Monolog, mediat dhe propaganda totalitare", Botimet Dudaj, Tirane, 2010.
3. Bakhtin, M., (1975). The Dialogic Imagination: Four Essays. University of Texas Press.
4. Bernays, E., (1928). Propaganda. Horace Liveright.

5. Claude Duchet, « Une écriture de la socialité », *Poétique*, n° 16, 1973, fq. 446-454.
6. Chomsky, N. & Herman, E. S. (1988). *Manufacturing Consent: The Political Economy of the Mass Media*. Pantheon Books.
7. Foucault, M., (1975). *Discipline and Punish: The Birth of the Prison*. Pantheon Books.
8. Groys, B., (1992). *The Total Art of Stalinism: Avant-Garde, Aesthetic Dictatorship, and Beyond*. Princeton University Press.
9. Ismail Kadare, “Dimri i vetmisë së madhe”, Shtëpia botuese Onufri, 2012.
10. Joseph R. Dominick, “Dinamika e komunikimit masiv, media në periudhën digjitale” UET Press 2010.
11. Jhon Berger, Howard Daniel, Antonie Carrigues, “Réalisme socialiste”, në www.universalis.fr
12. Kemple, T. D., (1991). *The State and the Media in Totalitarian Regimes*. Cambridge University Press.
13. Roland Barthes, “Théorie du texte sur le lien”, www.universalis.fr.
14. Roland Barthes, (1953), “Le Degré zéro de l’écriture”, në http://palimpsestes.fr/textes_philo/barthes/degre-ecriture.html
15. Roland Barthes, “L’écriture de l’événement: në: *Communications*, 12, 1968. Mai 1968. La prise de la parole. Fq. 108-112.
16. Agron Tufa, në: <https://palimpsest.al/realizmi-socialist/>
17. Patrick Charaudeau, “Les médias, un manipulateur manipulé”, në *La manipulation à la française*, Ed. Economica, Paris, 2003.
18. Orwell, G. (1949). 1984. Secker & Warburg
19. Koleksioni i Gazetës “Zëri i Popullit”, Biblioteka Kombëtare.